



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANË**  
**AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË**  
**MARRËVESHJEN KUADËR**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik: “ALSTEZO” sha, **Adresa:** Lagjia Kryengritja e Fierit, FIER

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar/ Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës: **Nr.Ref-18438-09-10-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.60, datë 16 Shtator 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” shpk** **NIPT-t: L01314031**

Vlera e ofertës: 4.069.100 (katër milion e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e njëqind) lekë pa Tvsh

**2. Operatori ekonomik “ALSTEZO” sha** **NIPT-t: J63208420N**

Vlera e ofertës: 4.359.825 (katërmilion e treqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë pa Tvsh

**3. Operatori ekonomik “Besnik Meci” shpk** **NIPT- t: L12407012R**

Vlera e ofertës: 4.692.800 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind) lekë pa Tvsh

**4. Operatori ekonomik “ZOOM TYRES” shpk** **NIPT-t: L92427017E**

Vlera e ofertës: 5.350.000 (pesë milion treqind e pesëdhjetë mije) lekë pa Tvsh

## 5. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” shpk

NIPT-t: L62311016C

Vlera e ofertës: 5.405.700 (pesë milion e katërqind e pesëmijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

### 1. Operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” shpk

NIPT-t: L01314031G

Vlera e ofertës: 4.069.100 (katër milion e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e njëqind) lekë pa Tvsh

*Arsyet e mëposhtme:*

a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti Teknik pika 2.3.4 percaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën **1 (një) ambjent (servis),ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.**

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë ku të përcaktojë vendndodhjen sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronësi/qira

Ambjenti ku OE do ushtrojë veprimtarinë e kryerjes së shërbimit, riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve duhet të ndodhet brenda territorit të Bashkisë Tiranë, kjo për arsye te logjistikes dhe mbarëvajtjes se realizimit te kontrates.

Për këtë, operatori/et ekonomik ofertues, duhet të paraqes/in dokumentacion që vërteton pronësinë / huapërdorjen / qiramarrjen si më poshtë:

***Dokumentacion që vërteton pronësinë:***

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; **ose**
- kontrata e shitblerjes; **ose**
- kontrata e dhurimit; **ose**
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

***Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:***

- Kontratë huapërdorje.

Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë “Vilnik Motors” shpk konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur deklaratën për ambjentin sipas tabelës sa më sipër përcaktuar por nuk ka paraqitur dokumentacionin qe verteton pronësinë/ huapërdorjen apo qiramarrjen referuar kriterëve të vecanta për kualifikim.

Pra në rastin konkret operatori ekonomik “Vilnik Motors” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion provues për ambjentin ku do të ushtrojë veprimtarinë e kryerjes së shërbimit duke mos plotësuar kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor për paraqitjen e dokumentacionit për ambjentin referuar pikës 2.3.4të kriterëve të vecanta për kualifikim.

Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.**

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

**2.Operatori ekonomik “ZOOM TYRES” shpk**

**NIPT-t: L92427017E**

Vlera e ofertës: 5.350.000 (pesë milion treqind e pesëdhjetë mije) lekë pa tvsh

**Arsyet e mëposhtme:**

**b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, Kapaciteti Teknik pika 2.3.4 percaktohet se operatori ekonomik duhet te paraqesë:**

**2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambjent (servis),ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.**

Për sa me sipër operatori ekonomik te paraqes nje deklarate ku të përcaktojë vendndodhjen sipas formatit te mëposhtëm:

<b>Nr.</b>	<b>Vendodhja</b>	<b>Statusi</b>
1		Pronësi/qira

Ambjenti ku OE do ushtroje veprimtarine e kryerjes se sherbimit, riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve duhet te kete nje largesi jo me shume se 5 km nga parku i automjeteve te APR-se (Autoriteti kontraktues) qe ndodhet ne parkimin e ish Gardës së Republikës pranë digës së liqenit artificial të Tiranës kjo per arsye te logjistikës dhe mbarevajtjes se realizimit te kontrates.

Për këtë, operatori/et ekonomik ofertues, duhet të paraqes/in dokumentacion që vërteton pronësinë / huapërdorjen / qiramarrjen si më poshtë:

***Dokumentacion që vërteton pronësinë:***

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; **ose**
- kontrata e shitblerjes; **ose**
- kontrata e dhurimit; **ose**
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

***Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:***

- Kontratë huapërdorje.

Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë “Zoom Tyres” shpk konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën për ambientin sipas tabelës duke mos plotësuar kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik pika 2.3.4

***c) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, Kapaciteti Teknik pika 2.3.2 percaktohet se operatori ekonomik duhet te paraqesë:***

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesemarrës duhet të ketë **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht :

- 1 (nje ) motorrist
- 2 (dy) xhenerikë
- 1 (një) elektroaut

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë kontratat individuale te punes. Kriteri sipas pikes 2.3.2 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

Nga verifikimi i formularit permbledhes te vetdeklarimit te paraqitur nga operatori ekonomik “ZOOM TYRES” shpk në SPE në pjesën e tretë të tij Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit vetëm 1 (një) një punonjës xhenerik nga 2 (dy) të kërkuar duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.

Komisioni i vleresimit te ofertave për disponimin e stafit teknik pranon si prove paraprake deklarinin ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit të stafit. Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin që të ketë paraqitur si prove paraprake deklarinin e të gjithë punonjësve sikundër përcaktuar.

**d) Në Dokumentat Standarte të Tenderit : “ Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: në pikën 2.1.1 përcaktohet se:** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Operatori Ekonomik nuk përmush kriteri e kërkuar të pikës 2.1.1 ne DST pasi licenca e paraqitur: Liçens VII.3.B.1 (pika a,b,c,ç,d,dh) është paraqitur në emër të një personi fizik dhe jo në emër të operatorit ekonomik pjesmarrës në këtë tenderim . Sikundër personi fizik mbajtësi i kësaj licence nuk gjendet në asnjë deklarin të lidhjes së tij më operatorin ekonomik duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik pika 2.1.1

**e) Në Dokumentat Standarte të Tenderit : “Kapaciteti ekonomik dhe financiar: në pikën 2.2.2 përcaktohet se:** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore një periudhë për vitet financiare (2021, 2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vleres se perlllogaritur te kontrates. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

*Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka paraqitur: Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vleres se perlllogaritur te kontrates sikundër përcaktuar ne dokumentat e tenderit duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.2.2*

**e) Në Dokumentat Standarte të Tenderit : “Kapaciteti teknik” në pikën 2.3.6 përcaktohet se:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se disponon brenda ambjenteve të servisit 1 (nje) grope per kontrollin dhe riparimin e mjeteve te renda.

*Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka paraqitur asnjë deklaratë nga administratori i shoqërisë që disponon brenda ambjenteve të servisit 1 (një) grope për kontrollin dhe riparimin e mjeteve te renda. Ky kriter nuk përmbushet nga Operatori Ekonomik.*

**f) Në Dokumentat Standarte të Tenderit : “Kapaciteti teknik”: në pikën 2.3.7 përcaktohet se:** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas specifikimeve teknike përcaktuar nga autoriteti kontraktor

*Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka paraqitur deklaratë për Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit të cilat do të ofrohen të reja dhe sipas specifikimeve teknike përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Ky kriter nuk përmbushet nga Operatori Ekonomik.*

**g) Nga verifikimi i preventivit te operatorit ekonomik ”Zoom Tyres” shpk konstatohet se ka gabime në përlllogaritjen e vlerës së ofertës duke ndryshuar vlerën e saj nga 5.350.000 leke pa tvsh deklaruar ne formularin e çmimit të ofertës ne vlerën 6.893.512 lekë pa tvsh ku vlera e përlllogaritur**

me korigjim të ofertës kalon vlerën e fondit limit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. **Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.**

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”**

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “ZOOM–TYRES” sh.p.k.nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ALSTEZO” sha, me adresë: Lagjia Kryengritja e Fierit, FIER se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4.359.825 (katërmilion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e pesë) lekë pa Tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej: 4.692.800 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_